



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipality of Kacanik

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

“DESHMORET E LIRISE”

Nr. 20/1/2018

Kaçanik, 22.01.2018

KAÇANIK

Në bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, bënë këtë:

SHPLLJE E REKRUTIMIT

I. QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

TITULLI I VENDIT TË PUNËS: MJEK TË MJEKËSISË FAMILJARE- 2 (dy pozita)

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Koeficienti; 7.2 **Gr. H-543/1**

Numri i referencës së vendit të punës: 20// 1/2018

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Ofrim i shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe në teren
- Ofron ndihmë mjekësore për të gjitha sëmundjet në përgjithësi duke u përkujdesur në vazhdimësi për mbrojtjen e shëndetit.
- Jep këshilla mjekësore rreth mbrojtjes së shëndetit dhe sëmundjeve:
- Diagnostifikimi i sëmundjes dhe trajtimi i pacientit;
- * Udhëzon dhe trajton në mjekimin parandalues të sëmundjes.
- Kryen edhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi sa i përket mjekësisë familjare.

Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe ekzistues.

Kushtet e konkursit

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende pune përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta;

Shkollimi i kërkuar: Fakulteti i mjekësisë së përgjithshme

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Çertifikata e licencimit dhe dëshmi tjera të aftësimit,
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- Përvoja e punës e dëshirueshme

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas ligjit të punës Nr.03/L-212.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) **zyra nr.06**, brenda 15 ditë prej ditës së shpalljes së konkursit në shtyp.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, dëshmi të përvojës së punës, çertifikatën shëndetësore, kopjen e letërnjoftimit, licencën e punës, çertifikatën e lindjes, dëshminë se nuk është nën hetime .

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE U SHËRBEN TË GJITHË BANORËVE TË KOSOVËS DHE MIRËPRET APLIKACIONET NGA FEMRAT DHE MESHKUJT E TË GJITHA KOMUNITETEVE TË KOSOVËS

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë Drejtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare

